



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/06/22
Datë: 31.03.2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12,2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr: 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 27 të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Ligji Nr: 03/L-048, GZRK numër 2008/27) dhe nenit 22 paragrafi 22,1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (Vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26), **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më datë 30.03.2022 nxjerrë:

V E N D I M

për

ndryshimin e planit të buxhetit për të hyrat vetanake të vitit 2021

I. Me këtë vendim miratohet propozimi i kryetarit të Komunës së Junikut për ndryshimin e planit të buxhetit për shkak të rritjes së të hyrave vetanake gjatë vitit 2021 sipas tabelës dhe sqarimit në vijim:

Nr.	Te hyrat	Planifikimi	Realizimi Janar – Dhjetor 2021	Diferenca (+, -)
1	Te hyrat nga shërbimet kadastrave	8,449.00	18,736.00	10,287.40
2	Te hyrat nga urbanizmi	14,000.00	500.00	-13,500.00
3	Te hyrat nga administrata	6,900.00	6,288.00	-612.00
4	Te hyrat nga lejet për ush.vepr. bizneseve	6,000.00	4,772.00	-1,228.00
5	Te hyrat nga tatimi ne pronë dhe në tokë	69,553.00	89,598.59	20,045.59
6	Regjistrimi i Automjeteve	5,900.00	7,194.00	1,294.00
7	Te hyrat nga shëndetësia	6,000.00	7,387.00	1,387.00
8	Të hyrat tjera	6,000.00	9,943.50	3,943.50
	TOTALI	122,802.00	144,491.49	21,617.49

Shuma totale e të hyrave vetanake të inkasuara në periudhën Janar – Dhjetor 2021 duke përfshirë të gjitha të hyrat është gjithsejtë: **144,419.49€**. Shuma e planifikuar për vitin 2021 është **122,802.00€**, ku shifet se kemi tejkalim të inkasimit të të hyrave

vetanake për vitin 2021 në vlerë prej 21,617.49€ në këtë shumë janë të përfshira edhe hyrat nga Gjambat në trafik në shumën prej 4,798.50€.

Në mënyrë që të mundemi ti alokojmë tejkalimin e te hyrave, kërkojmë që te rritet planifikimi i te hyrave vetanake në shumë prej **21,617.49€**, totali i te hyrave për vitin 2021 te rritet nga 122,802.00€ në 144,419.49€.

Kjo rritje në vlerë prej 21,617.49€ të bartet si në vijim:

- Nën programin 48020 Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Bashkëfinancimi i përojekteve me kod të projektit 46030 – 3,966.39€.
- Nën programi 18020 Shërbime Publike – infrastruktura rrugore në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në projektin Asfaltimi i rrugës lokale Junik – Jasiq me kod të projektit 51315 – 10,651.10€.
- Nën programi 74200 Shërbimet e kujdesit primar shëndetësor në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve – 7,000.00€.

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa në realizimin e të gjitha procedurave administrative lidhur me ndryshimet e planit të buxhetit për rritjen e të hyrave vetanake të vitit 2021, nga pika I. e këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Ministria e Financave;
3. Zyra e Kryetarit;
4. Shërbimi i kuvendit të komunës;
5. Arkivi i Komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut
Shpejtim Gacaferi

